



THE  
WORLD  
BANK



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

# ANKETA E FUQISË PUNËTORE 2012

## REZULTATET PËR GJYSMËN E PARË TË VITIT 2012

Banka Botërore  
Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore  
Njësia për Reduktimin e Varfërisë dhe  
Menaxhimin Ekonomik

[www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)

Agjencia e Statistikave të Kosovës  
Departamenti i Statistikave Sociale  
Sektori i Tregut të Punës

[www.esk.rks-gov.net](http://www.esk.rks-gov.net)

# ANKETA E FUQISË PUNËTORE 2012

## REZULTATET PËR GJYSMËN E PARË TË VITIT 2012

### HYRJE

Anketa e Fuqisë Punëtore është realizuar në vitin 2012 dhe këto rezultate mbulojnë periudhën prej Janarit deri në fund të Qershorit 2012. Mbledhja e të dhënave ka vazhduar edhe për pjesën tjetër të vitit 2012 dhe në Korrik të vitit 2013 do të ketë një raport më të detajuar, që mbulon periudhën prej Janarit deri në fund të Dhjetorit 2012.

**Këto rezultate nuk mund të krahasohen me ato të Anketave të Fuqisë Punëtore të mëhershme për shkak të përmirësimeve të bëra në përfshirjen e aktiviteteve informale dhe bujqësore të të intervistuarve.**


Anketa e Fuqisë Punëtore ka intervistuar 18,100 individë në Kosovë, përfshirë komunat në veri. Analiza e paraqitur mëposhtë bazohet në përgjigjet e 11,809 personave në mostrën e Anketës së Fuqisë Punëtore, të cilët ishin në moshë të punës (15 deri 64 vjeç) dhe përbëjnë Fuqinë Punëtore potenciale në Kosovë.

### Statistikat kyçe

- Nga personat e intervistuar, që janë në moshë të punës, **36.8% janë ekonomikisht aktivë** – kjo do të thotë që ata janë të punësuar ose të papunësuar dhe po kërkojnë punë.
- Në mesin e atyre që janë ekonomikisht aktivë, **35.1 % janë të papunësuar. Kjo është Shkalla zyrtare e Papunësisë për Kosovë për vitin 2012 (gjysmën e parë).**
- Në mostrën e Anketës së Fuqisë Punëtore, **63.2 % e atyre që janë në moshë të punës janë ekonomikisht joaktivë.** Këta janë studentë, amvise dhe persona të tjerë, që nuk janë duke kërkuar punë.
- Nga tërë popullsia në moshë të punës (ata që janë ekonomikisht aktivë dhe ata që janë ekonomikisht joaktivë), 23.9 % janë të punësuar.

**Tabela 1.** Shkalla e Pjesëmarrjes në Fuqi Punëtore – përqindja e popullsisë në moshë të punës (15-64 vjeç) që janë në Fuqi Punëtore (numri i të intervistuarve =11,809)

	Shkalla e pjesëmarrjes në Fuqi Punëtore	Nivelet e konfidencës prej 95% <sup>1</sup>	
		Më i ulët	Më i lartë
Kosovë	<b>36.8%</b>	34.5%	39.1%
Urban	<b>41.7%</b>	38.6%	44.8%
Rural	<b>33.8%</b>	30.5%	37.1%
Meshkuj	<b>54.5%</b>	50.9%	58.0%
Femra	<b>18.6%</b>	16.4%	21.0%
Të rinjtë (mosha 15-24 vjeç)	<b>22.6%</b>	19.9%	25.5%




<sup>1</sup> Rezultati qëndron mes përqindjeve më të ulta dhe më të larta me nivel besimi prej 95%.

**Tabela 2.** Shkalla e punësimit – përqindja e personave të punësuar nga popullsia në moshë pune, të moshës 15 deri 64 vjeç (numri i të intervistuarve=11,809)

	Shkalla e Punësimit	Nivelet e konfidencës prej 95%	
		Më i ulët	Më i lartë
Kosovë	23.9%	22.3%	25.5%
Urban	29.8%	27.0%	32.7%
Rural	20.2%	18.3%	22.2%
Meshkuj	37.0%	34.3%	39.8%
Femra	10.3%	8.9%	11.9%
Të rinjtë (mosha 15-24 vjeç)	9.0%	7.7%	10.6%


**Figura 2:** Shkalla e Punësimit në Kosovë (%)  
Burimi: Anketa e Fuqisë Punëtore, Janar deri në Qershor 2012



**Tabela 3.** Shkalla e papunësisë – përqindja e personave të papunësuar në mesin e popullsisë aktive të moshës 15 deri 64 vjeç (numri i të intervistuarve=4,298)

	Shkalla e Papunësisë	Nivelet e konfidencës prej 95%	
		Më i ulët	Më i lartë
Kosovë	35.1%	31.9%	38.5%
Urban	28.5%	24.9%	32.4%
Rural	40.1%	35.6%	44.9%
Meshkuj	32.0%	28.9%	35.4%
Femra	44.4%	37.3%	51.9%
Të rinjtë (mosha 15-24 vjeç)	60.2%	55.1%	65.1%

**Figura 3:** Shkalla e papunësisë në Kosovë (%)  
Burimi: Anketa e Fuqisë Punëtore, Janar deri në Qershor 2012





THE  
WORLD  
BANK



UKaid  
from the British people



ask  
Agjencia e Statistikave të Kosovës  
Statistical Agency of Kosovo

# ANKETA E FUQISË PUNËTORE 2012 REZULTATET PËR GJYSMËN E PARË TË VITIT 2012

Për më shumë informacione, ju lutem kontaktoni:

T: +381 38 200 31 143

E: [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)

**Publikues:**

Agjencia e Statistikave të Kosovës  
Rruga Zenel Salihu, Nr. 4 Prishtinë, Kosovë

Kur përdorni këto të dhëna, ju lutemi theksoni burimin

Designby: **envinion**